

E kremtja “Fjetia e Hyjelindeses Mari”



Me bekim te Mitropolitit te Elbasanit Shpatit dhe Librazhdit, Imzot Andoni kremtuam Liturgjine Hyjnore ne kishen e Fjeties se Hyjlindeses Mari ne Shtermen. Bashke me Ate Aleksander Lushin meshoi edhe Ate Petro Halili, te ndihmuar edhe katekistet qe vazhdimisht kane qene te angazhuar me katekizmin dhe inisiativa te ndryshme ne kete famulli.

Ne fjalen e tij Ate Petro u ndal ne rendesine e besimit tone Orthodhoks dhe rendesine e ruajtjes se tij te paster sic na e kane lene te paret tane.

Kleriku ne fjalen e tij me kete rast pergezoi keshillin dhe te rinjte bashke me katekistet per kontributin e tyre dhe te donatoreve te pakursyer te cilet ndihmuan ne organizimi e panairit!

Ne fund u zhvillua nje takim miqesor me Kryetarin e Bashkise te Cerrikut z. Andis Salla te cilin e falenderuan per bashkepunimin dhe gadishmerine e ketij institucioni.(tabelat orjetuese, koshat,mirembajtje ambejentesh dhe infrastukturen rrugore e tjer).

Duhet theksuar qe Kisha Orthodhokse eshte perpjekur vazhdimisht brenda mundesive te saja te ndihmoje ne zbutjen e probleme sociale ne zonen e Cerrikut-Shtermenit.

Lavdi Perendise per te gjitha!

Geplaatst door [Lidhja Rinore Orthodhokse Elbasan "Bijtë e Dritës"](#) op [Vrijdag 28 augustus 2020](#)

[Lidhja Rinore Orthodhokse Elbasan "Bijtë e Dritës"/facebook](#)